


HULUMTIMI “RËNDËSIA E SHKOLLIMIT PËR KOMUNITETIN RAE” NË PRIZREN

OJQ “Për Mendje të Shëndoshë” ka dizajnuar dhe ka realizuar hulumtimin për rëndësinë e shkollimit për komunitetin RAE në kuadër të projektit “Edukimi për një të ardhmen më të suksesshme” të financuar nga ana e UNDP. Gjatë këtij hulumtimi kemi gjetur të plotësuar 77 pyetësor nga ana e fëmijëve si dhe 100 pyetësor nga ana e prindërve. Fëmijët sipas gjinisë kanë qenë 49 (63,64%) femra, 26 (37,77%) meshkuj dhe 2 (2,60%) nuk e kanë deklaruar gjininë. Moshë mesatare e tyre e fëmijëve ka qenë 15,28 vjeç. Prindërit sipas gjinisë ishin 58 (58%) femra dhe 42 (42%) meshkuj. Moshë mesatare e prindërve rezultoi 38,45 vjeç.


Pyetësi për fëmijë ka pasur 17 pyetje kurse ai për prindër 20. Shumica prej pyetjeve kanë qenë të ngjashme por me ca ndryshime në përputhje me moshën e synuar.

Në fillim me pyetjen e parë: Sa anëtar jeni në familjen tuaj? Kemi dashur të shohim nga ana demografike se sa e dendur duket një familje e komunitetit RAE. Siç shihet edhe në grafikun 1 rreth 50 % e familjeve janë me mbi 7 anëtarë të familjes.




Graf.1. Numri i antarëve në familje

Në vazhdim kemi shikuar edhe se sa fëmijë janë në familjet e komunitetit RAE dhe nga këtu na rezulton se afro 42 % (sipas prindërve) dhe 50 % (sipas fëmijëve) e familjeve kanë mbi 5 fëmijë.




Graf.2. Numri i fëmijëve në familje

Në vazhdim të saj kemi shikuar se sa prej fëmijëve të këtyre familjeve të respondentëve janë të përfshirë në shkollim (Graf.3).Më shqetësuesja del se afro 20% e asnjërit prej fëmijëve nuk janë duke vazhduar shkollimin. Poashtu 6 % e fëmijëve të përfshirë në anketë deklarojnë se e kanë ndërprerë shkollimin.




Graf.3. Numri i fëmijëve në familjet të cilët janë në shkollë

Me interesimin se sa vajza dhe sa djem shkojnë në shkollë kemi dashur të gjejmë se a ka dallim në mes të gjinive të fëmijëve që vazhdojnë në shkollë.




Graf.4. Sa vajza dhe sa djem shkojnë në shkollë?

Siç shihet edhe nga grafika 4 , më shumë djem se sa vajza janë duke vazhduar shkollimin. Më tej kemi shikuar për shkaqet e mundshme se pse e ndërprejnë shkollën ku kemi gjetur se edhe fëmijët edhe prindërit si arsye i japin kushtet e dobëta (37% me 47%). Është interesant dallimi në mes të fëmijëve që mentalitetin e shohin si arsye në 15 % të rasteve, ndaj 3 % të prindërve (Graf.5).




Graf.5. Arsyet e deklaruara për ndërprerjen e shkollimit

Nga 83 përgjigje të fëmijëve dhe 106 të prindërve (dmth. i kemi zbërthyer edhe përgjigjet me dy e më shumë faktorë) pastaj kemi shikuar se cili shkas veçanërisht është marrë si më i rëndësishëm (Graf.6) dhe nga ky diagram sërish rezultatet janë të njejta.




Graf.6. Arsyet e deklaruara për ndërprerjen e shkollimit (janë zberthyer edhe përgjigjet me dy-tre faktorë)

Na ka interesuar edhe niveli i shkrim/leximit tek fëmijët dhe te prindërit respondentë si dhe tek anëtarët e familjeve tyre nga ku gjejmë se 65 % e fëmijëve dinë shkrim/lexim dhe 55% e prindërve deklarojnë se dinë shkrim/lexim.




Graf.7. Shkrim leximi i respondentëve




Graf.8. Shkrim leximi i antarëve të familjes së respondentëve

Në grafikun numër 8 kemi vendosur përgjigjet se a dinë të gjithë anëtarët e familjeve të tyre shkrim/lexim dhe shohim se vetëm 20-25% e familjeve dinë të gjithë shkrim/lexim.




Grafiku.9. Kush ju ka ndihmuar gjatë shkollimit?

Përgjigjet e fëmijëve dhe prindërve siç shihet nga grafiku 9 janë bindshëm unike se askush nuk ju ka ndihmuar gjatë shkollimit të tyre, kurse familja arrin vetëm deri afro 15-20% të rasteve.



Graf.10. A është e rëndësishme shkolla për juve?


Në graf.10. kemi vendosur përgjigjet që kanë të bëjnë me nivelin e vetëdijesimit për rëndësinë e shkollimit dhe këtu shihet qartë se afro 80 % e respondentëve e shohin si të rëndësishme shkollimin për veten e tyre dhe fëmijët e tyre.




Graf.11. A jeni të detyruar të punoni?

Në graf.11. janë përmbledhur përgjigjet e fëmijëve se a janë të detyruar të punojnë dhe është shumë e dhimbshme se 76,62 % e fëmijëve deklarojnë – po. Kjo le të kuptohet nivelin shumë të lartë të tyre në përfshirjen në punë në moshën e fëmijërisë.

Në graf.12. poashtu kemi shikuar problematikën e punës së fëmijëve por edhe të prindërve dhe njëkohsisht edhe vështrimin e prindërve për punën e fëmijëve. Në këtë shihet se 47 % e prindërve punojnë,nga ana tjetër 24 % e tyre janë të mendimit se fëmijët duhet të punojnë.




Graf.12. A punoni ju apo i detyroni fëmijët tuaj të punojnë?




Graf.13. A mendoni që ka mjaft kushte për shkollimin tuaj?

Edhe fëmijët edhe prindërit janë bindshëm unik në mendimin se nuk ka mjaftë kushte për shkollimin e tyre- deri 70%.




Graf.14. Çka ju mungon për shkollim?

Siç shihet nga graf.14. ne pastaj kemi shikuar se cilat janë mungesat për shkollim, ku del qartazi se paratë janë vendosur më së shumti si diçka që ju duhet për shkollim. Kemi shikuar edhe të zbërthyer mungesat në rastet ku kemi pasur dy e më shumë faktor të cekur (graf.15). Edhe në këtë zbërthim paratë deri afro 50 % shihen si mungesë kryesore, në vendin e dytë librat që në një mënyrë prapë lidhet me paratë dhe tek në të tretën vjen siguria e tyre.




Graf .15. Çka ju mungon për shkollim (të zbërthyera përgjigjet me dy-tre faktorë)


Në interesimin tonë se çka mendojnë se ju duhet më shumë për të mësuar shkrimin dhe leximin komunitetit RAE kemi gjetur dallim të dukshëm në mendime derisa fëmijët në rreth 45% të rasteve e vendosin shkollën, prindërit këtë e bëjnë vetëm në 15% të rasteve. Prindërit nga ana tjetër i shohin të nevojshme kurset dhe atë në 28 % të rasteve për dallim prej fëmijëve që mendojnë 3 %.



Graf.16. Për të mësuar shkrimin dhe leximin-çka ju nevojitet?




Graf.17.Nëse shkoni në shkollë, a keni probleme?



Graf.18. Nëse fëmijët shkojnë në shkollë, a do të kenë probleme?


Në graf. 17 dhe 18 kemi hulumtuar se çfarë problemesh mund të dalin për fëmijët në shkollë dhe atë nga vështrimi i fëmijëve dhe prindërve. Kështu 27 % e fëmijëve përkatësinë e tyre kombëtare e shohin si problem të mundshëm kurse prindërit në 42 % të rasteve e shohin si problem të mundshëm gjuhën e tyre.

Në grafikën 19 janë vendosur përgjigjet lidhur me qëndrimet për shkollën, ku shihet se veç pak mbi 50 % e tyre kanë besim te shkolla, kurse janë të pasigurtë 32 % e prindërve dhe 25 % e fëmijëve.




Graf.19.A keni besim te shkolla?

Më tej pesë pyetje u janë drejtuar vetëm prindërve. E para e cila është paraqitur në diagramin nr.20 ka të bëjë me atë se sa prej prindërve e kanë përfunduar shkollimin dhe kemi gjetur shifrën se vetëm 45 % e tyre e kanë kryer shkollimin fillor. Kurse 13% e tyre fare nuk kanë shkuar në shkollë.




Graf.20. A e keni përfunduar ju shkollimin?

Pyetja tjetër ka marrë parasysh përgjigjet se cilat janë arsyet e ndërprerjes së shkollimit të mëtejshëm tek respondentët prindër dhe kemi gjetur se si shkak të ndërprerjes shkollës në 33,33 % të rasteve prindërit e kanë përmendur martesën e hershme kurse po aq e përmendin edhe problemet me bashkësitë tjera etnike.




Graf.21. Nëse e ke ndërpre shkollimin, pse e ke ndërpre?

Në grafikun 22 kemi shikuar për gatishmërinë për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme po tu ofroheshin si plotësim për zotërimin e shkrim/leximit dhe kemi gjetur se 61 % e tyre janë të interesuar për këto.




Graf.22. Nëse do organizohen orë plotësuese për shkrim/lexim a do shkoni edhe ju ?

Më pas në grafikun numër 23 janë vendosur përgjigjet në pyetjen se a keni probleme në shtëpi nga të cilat ka rezultuar se 61% e tyre kanë shpesh probleme në shtëpi.



Graf.23. A keni probleme në shtëpi?

Pyetja e fundit ka pasur të bëj me dijen e prindërve për sjellje ose veprime ofenduese kundër fëmijëve të tyre në rrugë dhe shkollë; ku 35 % e tyre i pohojnë, kurse shumica ose 41 % deklarojnë se nuk e dinë.



Graf.24. A është ankuar fëmija juaj që është ofenduar ndonjëherë në shkollë ose jashtë saj?

Gjithashtu respondentëve i është lënë edhe mundësia e komenteve shtesë për ndonjë problematikë ose çështje që atyre u duket e vlefshme për ta vendosë në pyetësor. Kështu çështjet e prekura më shumë tek komentet e fëmijëve ishin ato lidhur me martesat e hershme si dhe me problemet familjare për të cilat kërkonin trajtim. Poashtu edhe komentet e prindërve kanë qenë të shumtën me tema nga dhuna.

Komentet e fëmijëve:

Martesa e hershme	3
Kërkesa për trajtim familjar	3
Ankesa per mesuesin	2
Dhune ne familje nga prindi	2
Lemosh	2
Ankesa nga nxënësit e tjerë	1
Ankesa nga OJQ	1
Ka nderpre shkollen per shkak se ka pas tentim dhunimi	1
Kërkon ndihm nga psikologu	1
Nevojë per burse	1
Problemi shendetsor me sy	1
Siguria ne shkolle	1

Komentet e prindërve:

Dhuna familjare	1
Dhuna nga mesuesja ndaj djalit tim	1
Martesa e hershme	1
Ofendimi i femijeve te tij nga mesimdhenesi	1
Pedagogu të jetë ne shkolla/psikologu	1
Probleme me stafin e shkolles	1